

Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës
Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filozofik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit filozofik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 22.06.2021, solli Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull **“Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral”**, të kandidatit Mr. Sc. Faton Murseli.

Në bazë të vendimit nr. 16-458//2, të datës 22.06.2021, Komisioni në përbërje: 1. Prof. Dr. Abdynaser Sinani, mentor, 2. Prof. Dr. Ibish Kadriu, anëtar, 3. Prof. Dr. Qani Nesimi, anëtar, 4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar, 5. Prof. Dr. Metush Sulejmani, anëtar, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filozofik i paraqet këtë

R A P O R T
për vlerësimin e disertacionit tëdoktoraturës

Të dhënat biografike të kandidatit:

Faton Mursel Murseli është lindur më 25 korrik të vitit 1987 në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut, ku ka kryer edhe shkollimin fillorë dhe të mesëm.

Studimet themelore i ka regjistruar në vitin 2006 në drejtimin Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, në Universitetin e Evropës Jug-Lindore në Tetovë dhe i ka kryer në shtator të vitit 2009, duke fituar kështu titullin akademik: Bachelor i Shkencave të Komunikimit. Si student ai ka shfaqur një angazhim të gjerë akademik duke iu besuar edhe detyra e kryetarit të klubit të komunikimit në kuadër të UEJL-së, dhe gjithashtu në vitet e studimeve (2009) ndjek trajnimin e organizuar nga Instituti për Zhvillim dhe Lidership, me temë “Zhvillimi i mediave dhe kulturës së komunikimit në Maqedoni”.

Pas kryerjes së studimeve themelore, kandidati Faton Murseli në vitin akademik 2009/2010 ka regjistruar ciklin e dytë të studimeve në nivelin master, në fushën e Shkencave të Komunikimit – Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimi i marketingut. Në të njëjtën kohë kandidati Faton Murseli ushtron profesionin e gazetarit në Radio Shkup. Nga viti 2010 emërohet udhëheqës i zyrës së informimit të Komunës së Tetovës dhe zëdhënës i saj. Në shtator të vitit 2017, fiton titullin akademik: Magjistër i Sheknacave të Komunikimit–Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimi i Marketingut, në temë: “Mënyrat e funksionimit të marrëdhënieve me publikun të partive politike shqiptare në Maqedoni”.

Studimet e doktoratës në fushën sociologjisë, në modulën socio-politik i ka regjistruar në vitin akademik 2018/19 në Universitetin e Tetovës nën udhëheqjen e Prof. Dr. Abdynaser Sinanit, në temë: “Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral”, të miratua nga Këshilli mësimor Shkencor i F.Filozofik-Universiteti i tetovës, me numër 16-242/4 të 04.06.2020.

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidati Faton Murseli i ka kryer me sukses provimet e doktoraturës, konferencat doktorale, dhe obligimet tjera të parapara me Rregulloren për studimet e doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

Po në të njëjtin vit akademik, Faton Murseli në vitin 2018 pranohet si asistent i jashtëm në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor i sociologjisë.

Publikimet shkencore:

“Knowledge International Journal”

2019

Vol 34. 6, fq. 1733

“Sociology of communication between pessimism and modernization”

ISSN: 2545-4439

ISSN: 1857-923X

Revista ndërkombëtare “Albanologjia”

2020

Nr. 13-14, fq.203-210

“Lajmet e rrejshme”

ISSN: 1857-9485 (Print)

ISSN: 2545-4919 (Online)

Revista ndërkombëtare “Centrum”,

2020

Nr. 14, fq. 178-187

“Ndikimi social i mediave të reja në kohë pandemie”,

ISSN: 1857-8640 (Print)

ISSN: 1857-9396 (Online)

Revista ndërkombëtare “Social Studies”

2021

Vol. 15, No. 2 (52)

“Perspektivat ndërkulturore në kontekstin e integritimit Evropian – rasti i Maqedonisë së Veriut”

ISSN 2309-3455

Revista ndërkombëtare “Centrum”,

Korrik 2021

No. 15 – 2021

“Religious pluralism, state and society”

ISSN: 1857-8640 (Print)

ISSN: 1857-9396 (Online)

Pjesëmarrjet dhe referimet në konferencat shkencore:

Seminari XI Ndërkombëtare Albanologjisë,

Shtator 2017

Tema: “Mediat e reja”,

Universiteti i Tetovës (UT).

Seminari XII Ndërkombëtare i Albanologjisë

Tema: “Komunikimi multikulturorë,

Shtator 2018

Universiteti i Tetovës (UT).

Konferenca shkencore Ndërkombëtare e Institutit

“The power of knowledge”,

Tetor 2019

**Tema: “Sociologjia e komunikimeve mes
Pesimizimit dhe modernizimit”, Kavalla, Greqi.**

Seminari XIII Ndërkombëtare i Albanologjisë

Shtator 2019

Tema: “Lajmet e rrejshme”

Universiteti i Tetovës

6th International Conference

**“Migration, reasons, motives and consequences in
the society”, University of Tetova**

Nëntor 2019

International interdisciplinary Conference:

Mars 2021

**“Comparative Studies in Modern Society; Balkans in
European and Global Context”,**

University Ukshin Hoti in Prizren, Kosovo

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:

Kandidati Mr. Sc. Faton Murseli që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndeje, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar më shumë punime, artikuj shkencor në revista ndërkombëtare të fushë dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Analizë e punimit të doktoratës: "Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral"

Ky disertacion i doktoraturës ka një ndarje të përgjithshme prej dy pjesësh, pjesa e parë- pjesa teorike dhe pjesa e dytë empirike, ku janë shfrytëzuar tre metoda të hulumtimit varësisht nga rezultatet e pritura.

Disertacioni i doktoraturës është i strukturuar në shtatë krerë, sipas çështjeve që trajtohen dhe metodologjisë së shfrytëzuar.

Pjesa e parë e disertacionit të doktoraturës me titull "Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral" të kandidatit Mr. Sc. Faton Murseli, është pjesa teorike e cila përbëhet nga gjashtë (6) kapituj.

Ndërkaq, pjesa e dytë - empirike përfshihet në kreun e shtatë të këtij disertacioni.

Kreu i parë i titulluar "Mediat tradicionale kundrejt mediave të reja, nocionet dhe ndryshimi i rolit të tyre social", është një krahasim teorik ifunksionimit të mediave tradicionale në sferën e informimit gjatë fushatave paraelektorale me mediat e reja. Ky kapitull është i ndarë në tre nënkaptuj edhe atë "transformimi i mediave tradicionale dhe roli i ri i mediave në shoqëri", "Mediat tradicionale" dhe "Ueb-i dhe masivizimi i medias, teoritë mbi ta". Përveç një kapërcimi dhe krahasimi teorik të mediave tradicionale nga mediat e reja, janë përdorur referenca të duhura shkencore bashkëkohore, për të sqaruar rolin e ri të mediave në shoqëri si dhe ndryshimin dhe avancimin e ndikimit të tyre socio-politik.

Kreu i dytë përbëhet nga gjashtë nënkaptuj dhe titullohet "Roli i mediave përgjatë zhvillimit historik", e ku është hedhur një pasqyrim historik i evoluimit mediatik nga një informim "i vjetër" tradicional (i shkruar) tek një gazetari virtuale. Në këtë kapitull ka një rrjedhë të mirë kronologjike të zhvillimit historik mediatik me referenca dhe evoluime globale në aspektin medial, por e njëjta është e zbritur në praktikën e historisë mediatike në Maqedoninë e Veriut nga koha e ish Republikës Socialiste të Maqedonisë. Kështu që janë analizuar teknikat e informimit në Maqedoninë Socialiste duke krahasuar ato me teknikat e sotme të informimit përmes hibridizimit mediatik. Në nënkaptullin e gjashtë (6) të këtij kreu, është bërë një analizë teorike, e cila përfaqëson edhe kundërthëniet e sotme globale sipas së cilës: me gjithë zhvillimin historik të informacionit mediatik përcjellë gjatë fushatave paraelektorale, në veçanti, mediat e reja kanë "vlarë" apo jo ato tradicionalet.

Kreu i tretë i këtij disertacioni të doktoraturës me titull “Evolucioni mediatik”, është në fakt hyrje në thelbin e problemit të hulumtimit të këtij disertacioni, ku trajtohet rëndësia e mediave hibride për krijimin e opinionit paraelektoral. Ky kapitull është i ndarë në tetë (8) nënkapituj dhe përfaqëson pjesën më të rëndësishme të këtij hulumtimi ku bëhet definimi i komunikimeve hibride dhe mënyrën e sotme të përdorimit të tyre në aspektin e informimit mediatik, për parakushtet e krijimit të mediave hibride si edhe për logjikën mediale hibride. Në fakt, këtu ndahen dhe operacionalizohen nocionet themelore të problemit të kërkimit si janë: “komunikimet hibride”, “mediat hibride”, “gazetaria hibride”, “lufta hibride”, etj.. Pasi që ndahen qartësisht në mënyrë eksplicite teorike këto nocione, hidhet një pasqyrë e konceptit të të vepruarit dhe të menduarit në këtë realitet të ri të krijuar mediatik, dhe gjithashtu edhe për atë se struktura e re mediatike hibride rit apo zgjeron aktivitetet sociale-informative. Këtu merret parasysh edhe orientimi i trajtimit sociologjik të lëndës së vënë në studim, nëpërmjet studimit të rolit të mediave sociale në strukturën mediale hibride, në nënkapitullin e shtatë (7) të këtij kreu dhe gazetarinë në sistemin e mediave hibride, në nënkapitullin e tetë (8) të këtij kreu. Kapitulli i tretë “evolucioni mediatik” ka një rrjedhshmëri të duhur të definimit të koncepteve më bashkëkohore të funksionimit mediatik, hibriditetin e tyre, dhe impaktin e këtij evoluimi në shoqëri.

Kreu i katërt është i ndarë në shtatë nënkapituj, i titulluar “Mediat hibride dhe politika”, trajton tematika konkrete, ndoshta të paprekura më parë, e që ndërlidhen me raportet e mediave hibride me politikën. Kjo është gjithmonë në relacionin e duhur të temës boshte të këtij disertacioni të doktoraturës me titull “Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral”. Pasi që opinionit paraelektoral është rezultat i ndikimit politik dhe orvatjes së partive politike për ta ndikuar atë me anë të procesit të bindjes, kreu i katërt (4) bën pikërisht këtë elaborim të mënyrave bashkëkohore të funksionimit të mediave hibride në relacion me politikën. Në nënkapitullin e parë të këtij kreu që është i titulluar “shumëllojshmëria e dimensionit mediatik (hibriditeti) dhe pjesëmarrja politike përmes Komunikimit Politik, në fakt është bërë një ndërlidhje teorike mbi konceptet themelore të komunikimit politik dhe shumëllojshmërinë e përcimit të mesazhit nga burimi (në rastin konkret partitë politike) të marrësi (në këtë rast audienca dhe opinionit i gjerë publik). Zgjerimi i mesazhit mediatik që përçohet nga mediat hibride është trajtuar në krahasimin që bëhet në këtë kapitull mes komunikimit politik ndër-personal (inter-personal) dhe koncepteve më të reja të masivizimit të mesazhit mediatik (komunikimi masiv), ndihmuar nga sistemi mediatik hibrid. Në këto pikëpamje është hedhur një pasqyrim i disa nga efektet kryesore të masivizimit të mesazhit publik politik, siç janë efektet konjunktive apo edhe efektet e sjelljes (“behavior”), në konceptin socio-politik. Në nënkapitullin e pestë të këtij kreu hidhet një studim i thuktë mbi rolin e komunikimit politik përmes mediave hibride në prizmin e evolucionit të sotëm teknologjik. Është me rëndësi të theksohet, se në këtë kapitull, është trajtuar edhe teoria e “zërave alternativë”, një nga teoritë më aktuale bashkëkohore në konceptin e mediave hibride.

Kreu i pestë i titulluar “Sfera publike dhe audiencia në mjedisin e mediave hibride”, në fakt është trajtimi tjetër i rëndësishëm i çështjes së vënë në studim në këtë disertacion të doktoraturës. Ky kapitull ka qasje, rëndësi dhe referenca të rëndësishme sociologjike, si dhe prek nocione të reja për vendin tonë. Në fillim, trajtohet ndryshimi i mjedisit mediatik, pra krijimi i mjedisit të ri mediatik hibrid dhe komunikimi dhe kultura konvergjente që krijohet në këtë aspekt, gjithashtu, ndryshimi i audiencës si pasojë e rolit gjithnjë e më të madh të internetit në shoqëri, si dhe qasjet më të fundit dhe problematikat sociale në audiencën e krijuar nga roli i ri i mediave hibride në shoqëri. Në këtë kapitull trajtohet edhe ndarja sociale digjitale dhe pabarazia digjitale dhe krijimi i audiencës interaktive dhe pjesëmarrëse, me zhvillimin e mjedisit mediatik hibrid.

Kreu i gjashtë i titulluar “Fushata paraelektorale në kohën e mediave hibride”, është qasja e fundit teorike e këtij disertacioni të doktoraturës me titull “Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral” të kandidatit Mr.Sc. Faton Murseli. Me këtë kapitull, që është i ndarë në dhjetë nënkapituj, në mënyrë të kënaqshme përfundon qasja shkencore teorike e elaborimit të këtij disertacioni. Krijimi i opinionit paraelektoral në kohën e redaksive hibride, i referohet ndryshimeve bashkëkohore socio-komunikologjike dhe gjithashtu marrëdhënieve, gjithnjë në ndryshim në mes mediave hibride dhe partive politike, dhe rrjedhimisht me opinionin publik dhe audiencën. Në këtë kapitull, janë trajtuar fazat evolutive të komunikimit politik gjatë fushatave paraelektorale, rëndësia e mediave hibride gjatë fushatës paraelektorale, strategjitë paraelektorale në konceptet e shfrytëzimit të duhur të burimeve në realitetin e ri mediatik hibrid. E një rëndësie të veçantë, është paraqitja teorikike edhe modeli i ri i fushatave paraelektorale.

Në pjesën e fundit të këtij kreu janë shqyrtuar edhe devijimet e sotme socio-politike në raportin e politikës me redaksitë hibride, siç janë lajmet e rrejshme, gjuha e urrejtjes, kibernetika, të cilat janë tema të rëndësishme trajtimi dhe zgjerimi për periudhën e hulumtimeve të ardhshme.

Kreu i shtatë, plotësisht merret me përpunimin empirik të dhënave të mbledhura nga terreni për qëllimet e këtij disertacioni, si analiza dhe përpunimi i anketimit, analiza së përmbajtjes dhe interpretimit të intervistave. Në fakt, pjesa e dytë e ndarjes së përgjithshme të disertacioni, janë shpjeguar metodat e përdorura, mënyra e grumbullimit dhe analizës së të dhënave dhe rezultatet që rrjedhin nga to.

Në këtë disertacion, është shfrytëzuar qasje e përzier metodologjike si kërkesë e problemit të hulumtimit, si qasje sasimore ashtu edhe qasja cilësore, nëpërmjet pyetësorit anketues “online”, metodës së e intervistimit gjysmë të strukturuar dhe metodës së analizës së përmbajtjes.

Në këtë disertacion të doktoraturës, kandidati Faton Murseli, i paraqet gjetjet e hulumtimit empirik në përfundimet dhe sugjerimet e prezantuara, të cilat përçojnë mesazhe të rëndësishme shkencore, relevancë dhe janë edhe fokus studimesh bashkëkohore.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Ky disertacion doktorature me titull “Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral”, shfrytëzon metodologji që është e ndarë sipas problemit të hulumtimit. Problemi kyç i hulumtimit është se a shfrytëzohen si duhet apo jo redaksitë hibride nga partitë politike në krijimin e opinionit paraelektoral.

Prandaj në këtë disertacion doktorature janë shfrytëzuar tre metoda hulumtuese në mënyrë që në mënyrë më precize të arrihet te konkluzionet (përfundimet) relevante. Metodën dhe rezultatet nga to janë të paraqitura dhe diskutuara gjatë tërë hulumtimit, në varësi nga çështjet teorike që trajtohen. Por, mbështetja metodologjike dhe sqarimi i gjetjeve nga metodat është paraqitur në pjesën e dytë gjenerale të këtij disertacioni të doktoraturës – pjesën empirike. Kjo pjesë zhvillohet nga Kreu i shtatë (7) me titull “Metodat e hulumtimit shkencorë”.

- Përmes metodës së analizës së përmbajtjes, me të cilën janë analizuar publikimet e informacioneve (lajme, intervista, propaganda etj) gjatë fushatave paraelektorale, në relacion me pjesën teorike duke analizuar publikimet nga fushatat të cilat koncentronin përhapjen e mesazhit në mediat tradicionale (të shtypura) deri tek koncentrimi i publikimit të mesazheve paraelektorale te mediat hibride. Kjo metodë vë në studim përmbajtjen e informacioneve gjatë katër cikleve zgjedhore, edhe atë i pari pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë (në vitin 1990), i dyti pas konfliktit të armatosur në Maqedoni (viti 2002), i tretë gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014, dhe i tetë gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020. Këto periudha kohore, respektivisht zgjedhjet parlamentare, janë zgjedhur për shkak të specifikave kohore të tyre në relacion me hulumtimin që kryhet në këtë disertacion të doktoraturës. Faza e parë e periudhës së vitit 1990 trajton zhvillimin e fushatave paraelektorale që koncentronin publikimet e tyre në mediat tradicionale (në të shumtën e rasteve në shtypin e shkruar), dhe kështu në analizë janë vënë gazetat ditore. Faza e dytë e hulumtuar, respektivisht periudha e vitit 2002, është fazë pasi Maqedonia kishte dalë nga konflikti i armatosur, dhe komunikimi i fushatës paraelektorale njihet me një tendencë të rritjes së diskursit nacionalist. Faza e tretë e analizuar është ajo e zgjedhjeve të vitit 2014 apo ajo që quhej “afëra e përgjimeve” ku në kontekstin e substancës që trajtohet në hulumtim kemi të bëjmë me një “luftë hibride” dhe faza e katërt e trajtuar përmes metodës së analizës së përmbajtjes është ajo e vitit 2020, atëherë kur edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut haset një transformim mediatik, apo krijim i realitetit të ri mediatik hibrid, e sidomos si pasojë e ndikimit të pandemisë globale Covid-19.
- Përmes metodës së intervistës gjysmë të strukturuar, përmes së cilës janë testuar pyetjet e hulumtimit dhe janë marrë përgjigje dhe rezultate specifike të evoluimit mediatik në

Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe për mënyrat e përdorimit të mundësive të reja mediatike hibride nga partitë politike në Maqedoninë e Veriut. Kështu që janë intervistuar katërmëdhjetë (14) personalitete nga fusha e komunikimit, gazetarisë, sociologjisë, njohës të çështjeve politike, sociologjike dhe mediatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

- Përmes anketimit “online” përmes aplikacionit “google forms” janë përgjigjur gjithsej 360 të anketuar. Pyetjet e anketimit “online” kanë të bëjnë dhe janë fokusuar në rritjen e frekuentimit të mediave hibride sidomos gjatë periudhës së pandemisë globale Covid-19. Me anë të anketimit janë përfituar rezultate mbi atë se sa opinioni ka njohuri mbi informacionet që plasojnë mediat hibride, se a u beson atyre, a i ndjek apo edhe se si kuptohet termi “redaksi hibride” nga opinioni i gjerë.
- Me shfrytëzimin e këtyre tre metodave është arritur te rezultate dhe përfundime interesante dhe me relevancë që i japin vlerë të shtuar këtij disertacioni të doktoraturës.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Në mënyrë që rezultatet e këtij hulumtimi të jenë relevante, dhe të lidhura ngushtësisht me temën që trajtohet :“Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral”, është dashur që të ngritën hipotezat, dhe pyetjet e parashtruara gjatë formulimit të tezës së doktoraturës. Në varësi nga segmentet që trajtojnë hipotezat e ngritura janë përdorur edhe metodat përkatëse ashtu që të arrihet në rezultate më të sakta. Për të vërtetuar atë se në dhjetëvjeçarën e fundit mediat e reja janë bërë pjesë e njeriut bashkëkohorë, rezultatet më të vlefshme janë arritur me anë të anketimit mbi qasjen e mediave të reja, konceptin e hibridizimit dhe përdorimin e mediave hibride nga politika shqiptare në RMV-së. Ndërkaq përmes metodës së intervistimit gjysmë të strukturuar, si metodë cilësore, janë vënë në pah devijimet e ndryshme informative, komunikologjike që ndikojnë në jetën e përgjithshme sociale. Me anë të metodës së analizës së përmbajtjes janë analizuar materiale informative (lajmet, raportimet, etj.) është trajtuar kapërcimi logjik nga mediat tradicionale tek mediat e reja për të hetuar sociologjikisht konceptin bashkëkohorë të hibridizimit të tyre, në realitetin socio-politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Hipoteza kryesore e ngritur në këtë disertacion doktorature është:

- Mediat e reja në dhjetëvjeçarën e fundit janë bërë pjesë e rëndësishme e njeriut bashkëkohor. Ato shfrytëzohen në forma, mënyra dhe për qëllime të ndryshme, si moment jete, ngjarje, qëndrime apo edhe për shkëmbim informacioni dhe krijim të opinionit publik. Supozimi i këtij disertacioni është që redaksia tradicionale në këto rrethana është e detyruar të reformohet për t’iu përgjigjur kërkesave të kohës, në një redaksi hibride. Edhe përkundër mundësive të mëdha që ofrojnë mediat e reja (redaksia hibride) të përfshirjes edhe në lexuesve në krijimin e lajmit apo shprehjes së mendimit, shpejtësisë së përhapjes së informacioneve, përsëri partitë politike bashkë me udhëheqësit e fushatave paraelektorale të partive politike në RMV nuk kanë arritur t’i shfrytëzojnë mundësitë që i ofrojnë redaksitë hibride.

Më tej, në këtë disertacion të doktoraturës janë ngritur edhe hipotezat e veçanta:

- Udhëheqësit e fushatave paraelektorale të partive politike shqiptare në RMV nuk i shfrytëzojnë sa duhet mundësitë që i ofrojnë redaksitë hibride;
- Një pjesë e konsiderueshme e mediave të reja nuk informojnë në mënyrë profesionale gjatë fushatave praelektorale në RMV;
- Redaksitë hibride mund të krijojnë opinion paraelektoral;
- Mediat e reja kanë ndikim tek elektorati shqiptar në RMV, në ndërtimin e opinionit gjatë fushatave paraelektorale;
- Redaksitë hibride nuk pranojnë mjaftueshëm te elektorati shqiptar, si pasojë e paragjytimeve ndaj mediave të reja;
- Mediat e reja nuk paraqesin kujdesin e nevojshëm të etikës gjuhësore në komunikimin me elektoratin.

Ky disertacion i doktoraturës ka arritur edhe rezultate hulumtuese-shkencore dhe iu është përgjigjur edhe pyetjeve shkencore të parashtruara gjatë formulimit të disertacionit të doktoraturës, siç janë:

- Cili është roli i mediave hibride në shoqëri, dhe në veçanti në shoqërinë tonë në RMV?
- Sa kontribuojnë këto media për realizimin e fushatave paraelektorale?
- A thua forcat politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut i shfrytëzojnë të gjitha mundësitë resurset elektorale që i ofrojnë këto media?

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:

Tema që trajton kandidati Mr. Sc. Faton Murseli në këtë disertacion doktore, është mjaft e re, dhe si e tillë ka shumë pak hulumtime të kësaj sfare për realitetin e vendeve tona, sidomos të RVM-së. Koncepti i evoluimit mediatic, gjatë kësaj periudhe dhjetë-vjeçare dhe sidomos gjatë kohës së pandemisë globale Covid-19, mori rëndësi dhe përparësi të gjerë botërore, që implikoi edhe rrjedha socio-politike globale. Koncepti i hibridizimit, tashmë është shtruar si një praktikë e re në shumë segmente të jetës shkencore dhe institucionale me anë të kombinimit të aplikimit të gjerë të resurseve teknologjike. Koncepti i hibridizimit mediatic, si një shumë-dimensionalitet mundësish për politikën, në rastin konkret, por edhe për opinionin e gjerë, për të kontribuar në zhvillimin e jetës sociale, nxiti një zhvillim të ri të gjithanshëm.

Në këtë disertacion të doktoraturës kandidati ka shfrytëzuar burime teorike dhe pikëpamje socio-kulturore dhe politike mbi problemin e hulumtimit, për të gjetur dallimet dhe kundërshtitë konceptuale mbi rolin e mediave të reja me theks në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga koncepti i informimit njëdrejtimësh përmes mediave tradicionale (duke vënë në fokus shtypin e shkruar) të periudhës së viteve 1990-2000, deri te koncepti i informimit shumëdimensional reciprok tek mediat hibride.

E veçanta e këtij disertacioni qëndron në atë se kandidati ka arritur të intervistojë njohës të mirë të çështjeve mediatike, politike dhe sociale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:

Tema e disertacionit të doktoraturës “Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral” përfshin një studim të gjerë, por edhe specifik të koncepteve të shumta aplikuar por pak të njohura shkencërisht në RMV. Prandaj, kandidati ose edhe studiues të tjerë mund të trajtojnë shumë çështje të veçanta që prek ky disertacion.

Kandidati ka bërë përpjekje të pasqyrojë katër etapat kryesore të zhvillimit mediatik në RMV, që implikon edhe zhvillimin e përgjithshëm social. Prandaj, çështjet e ngritura në këtë disertacion janë një kontribut jo vetëm për sferën e sociologjisë politike, që ndër lidhet me krijimin e afiniteteve të shumta sociale si pasojë e zhvillimit mediatik, ndryshimin e mendimit të gjerë social për çështje të caktuara etj. Por, ky disertacion i doktoraturës mund të shërbejë për hulumtime shkencore në sferën e komunikimit dhe të mediave, në avancimin e sferës së marrëdhënieve me publikun në politikë, por edhe në sferën juridike, që lidhet me të drejtat dhe liritë e shprehjes dhe të informimit.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “Redaksia hibride dhe krijimi i opinionit paraelektoral”, të kandidatit Mr. Sc. Faton Murseli, ka nderin që t’i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani, mentor ;
2. Prof. Dr. Ibish Kadriu, anëtar ;
3. Prof. Dr. Qani Nesimi, anëtar ;
4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar ;
5. Prof. Dr. Metush Sulejmani, anëtar ;

Tetovë, korrik 2021